



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 205/2018

Datë: 30 prill 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 30 prill 2018, mori këtë:

VENDIM

- I. Obligohen të gjithë prokurorët dhe stafin administrativ të prokurorive t' i ndjekin trajnimet për përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).
- II. Përdorimi i SMIL në kryerjen e punëve të përditshme në prokurori është i obligueshëm, refuzimi apo çfarëdo forme e mospërdorimit do të jetë shkak për inicimin e procedurës disiplinore.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, është duke zbatuar projektin për zhvillimin dhe implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), për mes të cilit synohet të digjitalizohet procesi i punës në të gjitha prokuroritë e vendit. Parakusht për të filluar përdorimin e SMIL-it është aftësimi i të punësuarve në sistemin prokurorial për përdorimin e këtij sistemi. Për këtë qëllim Këshilli përmes Projektit TIK/SMIL planifikon të organizojë trajnimin e nevojshëm të gjithë të punësuarve në sistemin prokurorial për përdorimin e sistemit. Po ashtu është e nevojshme që të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial të bashkëpunojnë me stafin e projektit të TIK/SMIL gjatë procesit të trajnimit dhe përdorimit të sistemit sipas planit të aprovuar për zbatim të SMIL.

Andaj, nga ajo që u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Blerim Isufaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK-së;
- Të gjitha prokurorive
- Projektit TIK/SMIL
- Arkivit të KPK-së.